

## VENDIM

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, i përbërë prej:

Xhezair Zaganjori	Kryesues
Ardian Dvorani	Anëtar
Evelina Qirjako	Anëtare
Arjana Fullani	Anëtare
Andi Çeliku	Anëtar

në seancën gjyqësore të datës 11.07.2017, mori në shqyrtim çështjen që u përket palëve:

PADITËS: VALBONA SHEGANI

TË PADITUR: DEPARTAMENTI I ADMINISTRATËS  
PUBLIKE

### OBJEKTI:

Shfuqizimin e vendimit nr.66/4, datë 16.01.2014 të eporit të drejtpërdrejt të Drejtores së Drejtorisë së Zhvillimit, Menaxhimit të Burimeve Njerëzore dhe Inovacionit në Departamentin e Administratës Publike për marrjen e masës disiplinore “Largim nga Shërbimi Civil” ndaj paditëses Valbona Shegani, si të pabazuar në prova dhe ligj.

Shfuqizimin e vendimit nr.66/5, datë 07.02.2014 të Drejtorit të Departamentit të Administratës Publike për lirimin nga shërbimi civil të paditëses, si një vendim i paligjshëm, pasi bazohet në një vendim të kundraligjshëm të eporit të drejtpërdrejtë.

Kthimin e paditëses në detyrën e mëparshme, si specialiste për politikën e rekrutimit dhe konfirmimit në sektorin e zhvillimit dhe menaxhimit të burimeve njerëzore në Departamentin e Administratës Publike.

Detyrimin e anës së paditur Departamenti i Administratës Publike të kryejë pagesën e paditëses Valbona Shegani nga dita e ndërprerjes së marrëdhënieve financiare.

Baza Ligjore: Nenet 20, 25 të Ligjit nr.8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil”, nenet 7/c, 9, 11, 15/c, 16, 17, 18 të Ligjit nr.49/2012 “Për organizmin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe funksionimin e mosmarrëveshjeve administrative”; VKM nr.306, datë 13.06.2000 “Për disiplinën në shërbimin civil”; VKM nr.231, datë 11.05.2000 “Për pranimin në shërbimin civil dhe periudhën e provës”.

**Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tirane, me vendimin nr.1918, datë 28.04.2014 ka vendosur:**

- Pranimin e pjesshëm të kërkesë padisë.
- Shfuqizimin e veprimit administrativ të pasqyruar në vendimin nr.66/4, datë 16.01.2014 të Drejtorit të Drejtorisë së Zhvillimit, Menaxhimit të Burimeve Njerëzore dhe Inovacionit, pranë Departamentit të Administratës Publike.
- Detyrimin e palës së paditur, Departamenti i Administratës Publike të kthejë paditësen Valbona Shegani në vendin e mëparshëm të punës.

- Detyrimin e palës së paditur, Departamenti i Administratës Publike ti paguajë paditëses Valbona Shegani pagën nga momenti i ndërprerjes së marrëdhënieve financiare deri në rikthimin e paditësit në punë.
- Rrëzimin e kërkesë padisë për shfuqizimin e veprimit administrativ, shkresës nr.66/5, datë 07.02.2014 të Drejtoreshës së Departamentit të Administratës Publike.
- Shpenzimet gjyqësore siç janë bërë.

**Gjykata Administrative e Apelit Tiranë me vendimin nr.1911, datë 21.09.2015 ka vendosur:**

- Ndryshimin e vendimit nr.1918, datë 28.04.2014 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.
- Pranimin e kërkesëpadisë;
- Konstatimin e pavlefshmërisë absolute të vendimit nr.66/4, datë 16.01.2014 të Drejtores së Drejtorisë së Zhvillimit, Menaxhimit të Burimeve Njerëzore dhe Inovacionit në Departamentin e Administratës Publike dhe të vendimit nr.66/5 të Drejtorit të Departamentit të Administratës Publike;
- Detyrimin e palës së paditur të rikthejë paditësen Valbona Shegani në vendin e mëparshëm të punës ose në një vend ekuivalent me vendin e mëparshëm të punës;
- Detyrimin e palës së paditur t'i paguajë paditëses pagën nga momenti i ndërprerjes së marrëdhënieve të punës deri në ekzekutimin e vendimit;
- Ky vendim përbën titull ekzekutiv të ekzekutueshëm nga Shërbimi Përmbarimor Gjyqësor;
- Shpenzime gjyqësore i ngarkohen palës së paditur;

**Kundër këtij vendimi, ka paraqitur rekurs pala e paditur Departamenti i Administratës Publike, e cila kërkon ndryshimin e vendimit nr.1911, datë 21.09.2015 të Gjykatës Administrative të Apelit dhe të vendimit nr.1918, datë 28.04.2014 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, si dhe rrëzimin e padisë...**

\*\*\*

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, mbështetur në nenin 63/e të Ligjit 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”,

V E N D O S I

**Lënen në fuqi të vendimit nr.1911, datë 21.09.2015 të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë.**

Tiranë, më 11.07.2017

**Nr. 31003-02536-00-2015 i Regj. Themeltar  
Nr. 00-2017- 1969 i Vendimit (761)**